

KODI I ETIKËS DHE SJELLJES PROFESIONALE

PËRMBAJTJA

1.1	HYRJE	4
1.2	FOKUSI I TIRANA BANK DHE GRUPIT BALFIN	4
1.3	PARIMET ETIKE TË TIRANA BANK DHE GRUPIT BALFIN	5
1.4	KOMUNIKIMI ME ETIKË DHE STANDARDE	8
1.5	INTEGRITETI I BANKËS DHE I GRUPIT	9
1.6	ASETET E BANKËS DHE TË GRUPIT	11
1.7	KËRKONI NDIHMË DHE RAPORTONI	12

Përse është i rëndësishëm?

Të nderuar kolegë,

Sjellja juaj etike dhe profesionale është një nga treguesit kryesorë të suksesit të Tirana Bank dhe Grupit Balfin. Reputacioni ynë si korporatë por edhe si individë, varet nga kjo. Ne besojmë se të gjithë në Tirana Bank dhe Grupin Balfin kanë një përgjegjësi të përditshme për të siguruar që emri “Balfin” të mbetet sinonim i përsosmërisë dhe profesionalizmit. Klientët dhe bashkëpunëtorët tanë investojnë para dhe besim në aktivitetin e shoqërive tona dhe në punën tonë të përbashkët. Është me rëndësi jetike që secili nga ne ti përmbahet standardeve më të larta etike. Kështu sigurojmë që Tirana Bank dhe Grupi Balfin jo vetëm ofron shërbimet më cilësore por edhe krijon një mjedis biznesi që pasqyron besimet tona themelore, që përfshijnë integritetin, konfidencialitetin dhe përgjegjësinë. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale i Tirana Bank dhe Grupit Balfin nxjerr në pah ato karakteristika kryesore të cilat respektojnë standardet më të larta profesionale. Ky kod jep udhëzime, informacione, dhe referenca të politikave të shkruara dhe burimeve për t’ju ndihmuar të bëni zgjedhje të drejtë gjatë punës tuaj të përditshme. Ky kod nuk ka si qëllim të mbulojë çdo situatë të mundshme me të cilat ju përballeni por duke u njohur me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale do ta keni më të lehtë punën tuaj të përditshme.

Shpresoj në mbështetjen tuaj,

Samir Mane
President i Grupit Balfin

1.1 Hyrje

Kodi përmban udhëzime në drejtim të angazhimit të Bankës dhe të Grupit drejt integritetit personal, etikës profesionale dhe respektit ndaj aseteve të shoqërive. Ai gjithashtu ofron pyetje dhe përgjigje, shembuj dhe informacion se ku duhet të adresohemi për të gjetur udhëzime më të hollësishme mbi tema të ndryshme lidhur me kodin e sjelljes.

Është detyrim i çdo punëmarrësi të Tirana Bank dhe të Balfin, të njohë dhe respektojë kodin e etikës.

“Kodi i Sjelljes Etike dhe Profesionale” është i ndarë në disa seksione të cilat janë në përputhje me vlerat që ne kemi identifikuar si më të rëndësishmet për Grupin tonë.

Këto seksione janë:

1. Fokusi i Tirana Bank dhe Grupit Balfin
2. Parimet etike të Tirana Bank dhe Balfin
3. Komunikimi me etikë dhe standarte
4. Integriteti i Bankës dhe i Grupit
5. Asetet e shoqërise

Q: Pse ne kemi nevojë për një kod sjellje?

A: Kodi i Sjelljes I Tirana Bank dhe Grupit Balfin përcakton pritshmëritë që ka Tirana Bank dhe Balfin për ju si punëmarrës dhe përcakton standartet për sjelljen në biznes

Q: Ky kod do të zbatohet në të gjitha shoqëritë e Grupit Balfin?

A: Po, ky kod vlen për të gjithë punëmarrësit në shoqëritë lokale dhe ndërkombëtare të Balfin, duke përfshirë Tirana Bank.

Reputacioni i mirë i Tirana Bank dhe Balfin ndërlidhet me integritetin në biznes. Të gjithë punëmarrësit që veprojnë në emër të Tirana Bank dhe Balfin duhet të respektojnë dhe ndjekin “Kodin e Sjelljes Etike dhe Profesionale”, pavarësisht vendndodhjes dhe natyrës së punës.

Në të gjitha ndërverprimet me palët e treta ne jemi të angazhuar për të vepruar me etikë dhe profesionalizëm.

Kodi shpreh pritshmëritë që Tirana Bank dhe Grupi Balfin kanë si punëdhënës. Gjithsesi ai nuk i jep përgjigje çdo pyetje që mund të lindë dhe nuk zëvendëson përgjegjësinë tonë personale për të vepruar me gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm. Në raste dyshimi për sjelljen jo etike, duhet të kërkonit gjithmonë suport dhe këshillë tek supervizori juaj.

Ju lutem referohuni te “Policies and Procedures” për këtë temë të publikuara në intranet të Tirana Bank to be adhered to by all Tirana Bank employees.

1.2 Fokusi i Tirana Bank dhe Grupit Balfin

Tirana Bank dhe Grupi Balfin janë të orientuar drejt arritjes së rezultateve dhe aplikimit të standardeve më të larta në të gjitha fushat ku operon duke sjellë shërbimet dhe idetë më inovatore në treg. Ajo që udhëheq në çdo hap Grupin është synimi për të qenë të parët dhe më të mirët. Besojmë shumë tek motivimi dhe dëshira e punëmarrësve për të realizuar projekte akoma më të mëdha në të ardhmen, jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon.

Elementët thelbësorë në strategjinë e zhvillimit të Grupit Balfin janë:

Aplikimi I standardeve më të larta

Ne kërkojmë në të gjitha shoqëritë e Grupit zbatimin e një politike rigoroze për krijimin dhe aplikimin e standardeve më të larta në çdo segment të shërbimit, tregëtimit, ndërtimit apo prodhimit. Falë këtij përkushtimi të vazhdueshëm për tu përmirësuar gjithmonë, ne jemi partneri i duhur dhe i besueshëm për të gjitha kompanitë e huaja që kërkojnë të investojnë në Shqipëri dhe rajon.

Zgjerimi dhe diversifikimi i operacioneve

Grupi Balfin synon që të zgjerojë gjithnjë pozicionin në tregun vendas dhe atë rajonal duke njohur dhe shfrytëzuar avantazhet konkurruese. Ne jemi gjithnjë në diversifikim të mëtejshëm të investimeve, duke synuar përfshirjen në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe identifikimin e oportuniteteve dhe ideve novatore.

Investimi për rritjen e shoqërive dhe ekspansionin

Të gjitha shoqëritë e Grupit përfitojnë nga sinergjia dhe nga shkëmbimet e ndërsjellta të eksperiencës. Të jesh Grupi më i madh në Shqipëri krijon mundësinë që të gjitha shoqëritë të kenë mbështetje të plotë jo vetëm manaxheriale por edhe financiare. Kjo garanton stabilitetin e të gjitha shoqërive të Grupit dhe suksesin e projekteve të reja duke krijuar besim e siguri maksimale tek të gjithë partnerët vendas dhe ndërkombëtarë.

Fokusi i Tirana Bank dhe Grupit Balfin

Punëmarrësit

Grupi Balfin, ndër punëdhënësit privat më të mëdhenj në Shqipëri, ndërton politika të cilat i mundësojnë punëmarrësve të marrin iniciativa dhe kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë dhe arritjen e rezultateve. Punëmarrësit janë partnerët më të vlefshëm për rritjen e shoqërive të Grupit Balfin dhe për këtë arsye i kushtohet vëmendje e veçantë zhvillimit dhe promovimit të tyre profesional.

Integriteti dhe etika e bashkëpunimit

Në çdo aktivitet të përditshëm Tirana Bank dhe Grupi Balfin zbaton etikën profesionale dhe i përmbahet të gjitha detyrimeve ligjore. Ne respektojmë çdo angazhim që marrim dhe jemi përgjegjës për të gjitha veprimet tona. Kjo na bën të jemi të hapur dhe të drejtë ndaj partnerëve në çdo bashkëpunim. Të gjitha shoqëritë e Grupit kanë krijuar partneritet me shoqëri vendase dhe të huaja duke treguar korrektësi dhe përkushtim në marrëveshjet dypalëshe.

Mjedisi dhe komuniteti

Tirana Bank dhe Balfin tregojnë përgjegjshmëri maksimale për punëmarrësit, klientët, furnitorët, partnerët, mjedisin dhe komunitetet ku zhvillojnë aktivitet. Shoqëritë e Grupit Balfin aplikojnë strategji të veçanta në përmirësimin e kushteve të komuniteteve lokale duke rritur punësimin apo duke mbështetur projekte të cilat kanë si qëllim zhvillimin social.

Në çdo investim tonin ne jemi shumë të kujdesshëm që të mos ketë ndikime negative mbi mjedisin dhe komunitetin. Ky është një angazhim, jo vetëm për të tashmen por edhe për brezat e ardhshëm.

1.3 Parimet Etike të Tirana Bank dhe Grupit Balfin

- Integritet dhe profesionalizëm
- Vlerë superiore për klientët dhe komunitetin
- Marrëdhënia me klientët dhe palët e treta
- Standartet më të mira të komunikimit

Të përfaqësojmë Tirana Bank dhe Grupin Balfin

Ne jemi Tirana Bank dhe BALFIN: mbartim vlerat, parimet dhe filozofinë tonë të shërbimit. Është përgjegjësia jonë për të siguruar që veprimet tona, fjalët dhe mendimet të pasqyrojnë në mënyrë të drejtë dhe përfaqësuese Bankën dhe Grupin tonë

- Përdor komunikim dhe sjellje profesionale.

- Përfaqëso politikat e Bankës dhe të Grupit dhe trajto njerëzit në mënyrë të drejtë.
- Trajto klientët si klientë të shoqërisë, jo si klientë personal.
- Largohuni nga efektet e drogës, alkoolit, ose substancave të tjera që mund të pengojnë performancën e punës ose gjykimin tuaj.
- Bëni dallimin mes veprimeve dhe pikëpamjeve personale dhe profesionale.
- Konsultohuni me menaxherët përpara se të përfshiheni në punë që kanë të bëjnë me mediat në mënyrë që të jeni në përputhje me politikat e Bankës dhe Grupit.

Punëmarrësit duhet të sillen me integritet dhe profesionalizëm dhe të veprojnë në mënyrë etike në të gjitha marrëdhëniet me publikun, klientët, konsumatorët, punëdhënësit, të punësuarit dhe rregullatorët.

Për informacione më të detajuara lidhur me detyrimet tuaja si punëmarrës referohuni “Politikave dhe Procedurave” e publikuar në intranet e Tirana Bank.

Integritet dhe profesionalizëm

Tirana Bank dhe Grupi Balfin presin nga të gjithë punëmarrësit e tyre integritet të lartë, ndershmëri dhe profesionalizëm. Të punosh me korrektësi, profesionalizëm, të jesh bashkëpunues dhe i motivuar për arritjen e rezultateve, janë vlerat që Grupi jonë vlerëson dhe provomon.

Vlerë superiore për klientët dhe palët e treta

Është përgjegjësi e jona të kontribuojmë në vlerat e shtuara që Banka dhe Grupi i japin klientëve dhe komunitetit. Ne punojmë me ekipe që kanë ekspertizën për të ofruar shërbime cilësore dhe profesionale.

Marrëdhënia me klientët dhe palët e treta

Marrëdhënia që kemi me klientët dhe palët e treta janë të rëndësishme për reputacionin dhe cilësinë e shërbimeve tona. Qëndrimi jonë profesional në këto marrëdhënie na ndihmon për të ndërtuar dhe për të mbrojtur reputacionin dhe vlerat tona. Është përgjegjësia jonë që të angazhohemi vetëm në marrëdhënie etike dhe profesionale me klientët dhe palët e treta.

Nga të gjithë ne pritët që:

- Të kryejmë punën tonë me ndershmëri, integritet dhe profesionalizëm.
- Të jemi transparent në veprimet dhe komunikimet që ndërmarrim për të përforcuar besimin dhe shmangur paqartësitë.
- Të vendosim ndershmërinë dhe integritetin mbi dëshirën për shpërblim personal.
- Të jemi të sjellshëm në të gjitha komunikimet, të përballemi me konfliktet në mënyrë konstruktive.
- Të pranojmë gabimet dhe të mundohemi t'i përmirësojmë.
- Të respektojmë rregulloret dhe procedurat e Bankës dhe Grupit tonë dhe klientëve tanë.

Ne promovojmë ambient pune të sigurtë, të respektueshëm, ku punonjësit u binden ligjeve të punës, kodeve dhe direktivave të Bankës dhe Grupit, dhe vlerësojnë cilësitë, diferencat dhe vlerat e njëri-tjetrit..

Respekt reciprok dhe vend pune pa abuzime (Harrasment Free)

- Ne marrim përgjegjësi personale për cilësinë e ambientit tonë të punës.
- Ne trajtojmë gjithkënd me të cilin punojmë me paanësi, dinjitet dhe respekt.
- Ne ndalojmë abuzimet dhe avancimet e çdo lloji dhe nuk tolerojmë intimidimin, sjelljet armiqësore apo ofenduese qofshin verbale apo me shkrim..

Termi abuzim mund të jetë i aplikueshëm për një gamë të gjerë sjelljesh abuzive të cilat përfshijnë:

- Avancime seksuale të padëshiruara
- Komente me tendencë seksuale
- Sulme dhe kërcënime fizike
- Demonstrimi i materialeve ofensive
- Shaka të palejuara
- Komente ofenduese në bazë të karakteristikave personale

Droga dhe Alkoli në Vendin e Punës

Ne nuk lejojmë përdorimin e alkoolit apo substancave të paligjshme përgjatë gjithë procesit të punës dhe biznesit në Tirana Bank dhe Balfin. Përdorimi, blerja, apo shitja e substancave të jashtëligjshme është e patolerueshme në Tirana Bank dhe Grupin Balfin madje personat e kapur që kryejnë të tilla veprime do të kalojnë autoriteteve. Ne përpiqemi që të përmirësojmë jetët tona si dhe të komuniteteve që i shërbejmë.

Standartet Etike të Punës

Ne promovojmë të drejtat e njeriut. Ne mbështesim dhe jemi në akordancë të plotë me ligjet dhe vendimet që janë të lidhura me promovimin, orët e punës, benefitet dhe kushtet e punës si dhe nuk lejojmë punën e fëmijëve.

Mbrojtja ndaj Mjedisit

Ne i arrijmë dhe i tejkalojmë të gjithë rregullat dhe ligjet për mbrojtjen e mjedisit dhe kërkojmë që edhe furnitorët tanë të bëjnë të njejtën gjë. Përpiqemi që të përdorim burimet natyrore me efikasitet, të ulim nivelin e ndotjes, si dhe të operojmë nëpërmjet ripërdorimit apo riciklimit kurdo që është e mundur.

Ne bashkëpunojmë shumë ngushtë me partnerë të jashtëm për të promovuar vlerat e mjedisit dhe praktikat më të mira. Mbrojmë mjedisin për veten tonë dhe për brezat e ardhshëm..

Vjedhja

Është e ndaluar rreptësisht vjedhja, abuzimi, shpërdorimi dhe keq menaxhimi me pasurinë e kompanisë. Çdo punonjës është i detyruar që në mënyrë institucionale të mbrojë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të kompanisë. Obligimi për mbrojtje të pasurisë dhe burimeve përfshin dokumentet, sistemin informativ dhe çdo informatë lidhur me kompani dhe nuk mund të zbulohen pa leje të personave kompetentë.

Mbrojtja e burimeve përfshin edhe pronën intelektuale, të drejtën e autorit, sekretet e punës, planet e biznesit, marketingun dhe tërë dokumentacionin e kompanisë, kështu që zbulimi apo tjetërsimi i tyre konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës. Edhe moslajmërimi për dëmtim apo vjedhje të burimeve përkatësisht pasurisë, konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës.

Mashtrimi

Mashtrimi në çfarëdo formë nuk do të tolerohet në Tirana Bank dhe kompaninë Balfin. Ne do të identifikojmë dhe hetojmë menjëherë të gjitha pretendimet ose rastet e aktiviteteve mashtruese.

Aktet mashtruese përfshijnë aktivitete si përvetësimi, keqpërdorimi apo parregullsi të tjera të qëllimshme financiare, falsifikim apo ndryshim i dokumentave, etj.

Shfrytëzimi i postit

Ju nuk mund ta shfrytëzoni postin tuaj në shoqëri, direkt ose indirekt, për përfitim privat. Këtu përfshihet shfrytëzimi i titullit ose postit për të mbështetur produkte, shërbime, ose ndërmarrje të tjera përveç produkteve dhe shërbimeve të kompanisë.

Furnizuesit e kompanisë nuk duhet të zgjidhen në bazë të lidhjeve personale.

Konfliktet e interesit

Ju keni përgjegjësinë të shmangni çdo situatë që do të rezultonte në një konflikt interesi ose në shfaqjen e një konflikti interesi. Për shembull, një konflikt interesi mund të lindë nëse ju punoni mbi një çështje/projekt/prodakt apo shërbim që ka lidhje me departamentin apo sektorin ku ju punoni dhe në të njëjtën kohë një i afërm ose shok i ngushtë punon ose është i interesuar të përfshihet në të njëjtin proces. Në një rast të tillë ju duhet ta raportoni rastin te eprori juaj, i cili mund t'ia caktojë çështjen dikujt tjetër në mënyrë që vendimmarrja të jetë transparente.

Interes financiar quhet gjithçka që mund të rezultojë në përfitim financiar për ju; mund të jetë pronësi mbi stokun, ose interes mbi një biznes ose pronë, ose punë..

Gjithashtu ju ndalohet të merrni pjesë në çështje të shoqërisë në të cilat përfshihen interesat financiare të familjes suaj; partnerit tuaj; ose një organizate në të cilën ju shërbeni si zyrtar, drejtues, anëtar bordi ose punonjës.

Ju dhe familja juaj nuk mund të pranoni dhurata, ushqime, favore, shërbime, zbavitje, ose çdo gjë tjetër në vlerë monetare nga ndonjë person ose organizatë që kërkon shërbim nga shoqëria, që bën ose kërkon të bëjë biznes me shoqërinë, ose që mund të ndikohet nga puna juaj në shoqëri.

Ju nuk mund të merrni pjesë në procesin e marrjes në punë të personelit të ri nëse kandidati është i afërmi juaj ose një shoku juaj. Nëse një pjesëtar i stafit është i afërmi juaj ose një miku juaj, atëherë pritët që ju ta jepni këtë informacion.

1.4 Komunikimi me etikë dhe standarde

Komunikimi është një element kyç i Tirana Bank dhe Grupit Balfin dhe është menyrë me të cilën ndahet informacioni, jepen udhëzimet, shprehen mendimet, opinionet dhe merren përgjigjet.

Etika me të cilën njerëzit komunikojnë ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e Grupit. Një komunikim efikas duhet të jetë i qartë, profesional, në kohë dhe i rëndësishëm. Kultura e komunikimit të mirë është përgjegjësi e të gjithë punëmarrësve brenda Grupit Balfin dhe është e rëndësishme që çdo anëtar i stafit të jetë i gatshëm për të marrë dhe për të dhënë informacion.

Kategoritë kryesore të komunikimit në Grup janë:

- **Komunikimet nga menaxhimi** – komunikimet strategjike që vijnë nga menaxhimi në lidhje me strategjinë, vizionin dhe misionin e Bankës dhe Grupit.
- **Komunikimet operacionale** - të gjitha komunikimet e brendshme dhe të jashtme që lidhen me funksionet e përditshme të punës.
- **Komunikimet e marketingut** - komunikimet e lidhura me fushata publicitare të Bankës dhe të shoqërive të Grupit.
- **Komunikimet jo zyrtare** – në këto komunikime përfshihen bisedat midis kolegeve dhe biseda jozyrtare.

Q. Unë kam marrë një e-mail me një kërkesë specifike nga një koleg, por unë jam shumë i zënë për t'u përgjigjur? A është profesionale kjo?

A: Jo, nuk është profesionale që të mos përgjigjeni në një e-mail. Ju duhet t'i përgjigjeni kërkesës në kohë. Por në cdo rast, nuk është profesionale nëse nuk përgjigjeni të paktën ditën tjetër të punës.

Q. Unë kam marrë një e-mail në të cilën janë kopjuar menaxherët e mi, por unë e kam deleguar detyrën te stafi im. Dëshiroj t'i përgjigjem direkt vetëm dërguesit të email-it. A është kjo profesionale?

A: Absolutisht jo. Ju nuk duhet të shkëpusni një rrjedhë të informacionit. Ka një arsye ose menaxherët janë kopjuar dhe ata duhet të ndjekin deri në finalizim të një detyre. Ju jeni të detyruar të ktheni përgjigjen të gjithëve.

Komunikimi me etikë dhe standarte

Dimensionet e komunikimit

Komunikimi kërkon plotësimin e tri dimensione kyçe që të jetë efektiv:

Për të informuar: të sigurojë bashkëbiseduesit me informacionet që i nevojiten për të kryer dhe kuptuar punën e tyre.

Për të dëgjuar: të dëgjuarit në mënyrë interaktive është me rëndësi jetike, me cilëndopale të interesit jeni të angazhuar në komunikim.

Për të biseduar: krijimin e kanaleve të komunikimit të dyanshëm për të inkurajuar përfshirjen dhe dialogun midis grupeve të interesit.

Cfarë konsiderohet komunikim jo-etik në ambientin e punës?

Shtrëngues: Frikësimi dhe kërcënimi i të tjerëve.

Destruktive: Shaka kërcënuese dhe e papërshtatshme.

Mashtruese: Të gënjerit dhe abuzimet.

Thashethemet: Të fillosh dhe të qarkullosh thashetheme.

Ndërhyrëse: Të dëgjuarit të bisedave të të tjerëve dhe cënimi i privatësisë.

I fshehtë: Mos ndarjen e informacionit.

Nga të gjithë ne pritët që:

Të komunikojmë në mënyrë profesionale dhe të respektojmë kodin e etikës në çdo komunikim formal ose jo formal gjatë orarit të punës.

1.5 Integriteti i Bankës dhe i Grupit

Integriteti në biznes

“Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale” I Tirana Bank dhe Grupit Balfin vendos standarde të larta të integritetit të biznesit. Respektimi i këtyre standardeve është një parakusht për suksesin e qëndrueshëm të Bankës dhe Grupit.

Çdo punëmarrës i Bankës dhe i Grupit kontribuon në integritetin e Balfin, me anë të sjelljes së tij apo të saj. Balfin kryen aktivitet në nivel ndërkombëtar, sjelljet jo etike të një punëmarrësi në një vend mund të ketë pasoja negative për Grupin edhe në tregun ndërkombëtar. Termat dhe kushtet që përcaktojnë sjelljen e duhur në transaksionet e biznesit duhet të vlerësohen rast-pas-rasti duke marrë në konsideratë të dhënat përkatëse të secilit rast individualisht

Tirana Bank dhe Grupi Balfin u ofron punëmarrësve të tij informacione të nevojshme, udhëzime dhe mbështetjen e duhur që çdo aktivitet të jetë në përputhje me standardet më të larta të integritetit të biznesit.

Q: Menaxheri direkt më ka vendosur një objektiv shitjesh ambicioz. Për të arritur objektivin dhe për të fituar një bonus, mua do të më duhet të shkel standartet dhe integritetin e biznesit të Bankës dhe Balfin. A mund ta bëjë këtë?

A: Jo. Nga ju kërkohet që të veproni gjithmonë në përputhje me standartet dhe integritetin e biznesit të Bankës dhe Grupit Balfin. Nëse ju nuk e bëni këtë, ju do të jeni I vetmi përgjegjës. Diskutojeni hapur situatën me menaxherin tuaj direkt për të gjetur një zgjidhje që është në përputhje me standartet dhe integritetin e biznesit.

Q: Menaxheri im direkt më kërkon të bëj dicka e cila sipas mendimit tim nuk është në përputhje me standartet e Bankës dhe Balfin e të integritetit të biznesit. Cfarë pritët nga unë në këtë rast?

A: Menjëherë diskutoni me menaxherin tuaj rezervat që keni. Kjo mun të kërkojë guxim, por është gjëja e drejtë për të bërë. Dhe mos harroni, ju jeni në fund të fundit përgjegjës për sjelljen tuaj profesionale. Nëse Menaxheri juaj këmbëngul për të mabjtur konfidencialitet, ju duhet të adresoheni menjëherë problemin tek një nivel me lart nga supervizori juaj, tek Departamenti I Burimeve Njerëzore ose në adresën e e-mailit:: për Tirana Bank te whistle-blowing@tiranabank.al; ose për Grupin Balfin te raporto@balfin.al.

Nga të gjithë ne pritët që:

Të vlerësohet me kujdes, rast-pas-rasti, nëse sjellja profesionale e jona është në përputhje me pritshmëritë, standardet dhe integritetin e biznesit të Tirana Bank dhe Grupit Balfin..

Të kujtojmë se integriteti I Tirana Bank dhe Grupit Balfin varet nga sjelljet tona.

Integriteti I Bankës dhe I Grupit / Raportim cilësor

Ne duhet të sigurohemi që çdo e dhënë apo informacion që kemi krijuar, apo për të cilat ne jemi përgjegjës, është i vërtetë dhe i drejtë. Këto të dhëna mund të jenë të formave të ndryshme, duke filluar nga raportimet financiare, kërkimi dhe analizimi i të dhënave dhe deri te plotësimi i të dhënave të udhëtimit dhe shpenzimeve personale apo edhe përmbajtja e e-maileve.

Ju mund të merrni këshilla në çdo kohë në lidhje me raportimin cilësor të llogarive nga menaxheri juaj ose ekspertët financiarë të shoqërive tuaja. Nëse besoni në mirëbesim se dikush ka bërë, është duke bërë, ose mund të jetë gati për të bërë diçka që shkel dispozitat në lidhje me raportimin e saktë dhe të drejtë, në një biznes ku Balfin është i përfshirë duhet të raportoni duke përdorur kanalet e raportimit që Tirana Bank dhe Grupi Balfin ka vënë në dispozicionin tuaj. Integriteti i të dhënave është element kyç i bizneseve tona.

Tirana Bank dhe shoqëritë e Grupit Balfin duhet të operojnë në përputhje me ligjet në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit duke siguruar që informacioni që i jepet auditorëve të tij dhe palëve të interesuara të jetë i saktë.

Falsifikimi i regjistrimeve dhe llogarive, ose shtrembërimi i fakteve mund të përbëjnë mashtrim. Përveç përgjegjësisë së Tirana Bank dhe Balfin, punëmarrësit që përfshihen në sjellje të tillë të paligjshme mund ti nënshtrohen edhe masave të rënda ligjore.

Q: Kohët e fundit kam bërë shumë udhëtime biznesi dhe kam humbur disa nga faturat e mia të hotelit. Një koleg I cili ka qënë në këtë situatë thotë se është praktikë normale për të paraqitur disa fatura të tjera. A është kjo e drejtë?

A: Jo. Nëse ju bëni këtë, ju do të falsifikoni të dhënat tuaja të shpenzimeve, dhe kjo nuk është e pranueshme. Ju duhet të bisedoni me Menaxherin tuaj ose Departamentin e Burimeve Njerëzore për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme.

Integriteti i Bankës dhe Grupot / Privatësia e të dhënave

Tirana Bank Grupi Balfin aplikon dhe respekton ligjin për "Mbrotjtjen e të Dhënave Personale" të lëshuar nga shteti Shqiptar. Ju mund të merrni ndihmë dhe këshilla të mëtejshme në lidhje me mbrotjtjen dhe përpunimin e të dhënave personale nga menaxheri juaj ose Departamentin Ligjor i Tirana Bank. Përveç kësaj, nëse besoni në mirëbesim se në lidhje me një biznes ku Tirana Bank është i përfshirë, dikush ka bërë, është duke bërë, ose mund të jetë gati për të bërë diçka që shkel dispozitat në lidhje me privatësinë e të dhënave, ju duhet ta raportoni atë.

Të gjitha përpunimet e të dhënave personale duhet të ruhen në përputhje me ligjet e mbrotjtjes së të dhënave dhe rregullave të Tirana Bank dhe Balfin.

Q: Unë punoj si specialist i Burimeve Njerëzore dhe kam akses në të dhënat personale të cilat unë do të doja ti ndaj me një koleg apo mik të ngushtë. A është në rregull kjo?

A: Duke qënë përgjegjës i Burimeve Njerëzore ju keni akses në të dhëna të personelit dhe si një punëmarrës i Tirana Bank ju keni një detyrim të rreptë për të trajtuar të tilla informacione si konfidenciale.

Nga të gjithë ne pritët që:

Të sigurojmë përpunimin e të dhënave personale me kujdesin e duhur dhe në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregullat e Tirana Bank dhe Grupit Balfin.

Asnjëherë mos të mblidhni më shumë të dhëna personale se sa nevojiten.

Përpunojmë të dhënat personale në përputhje me qëllimin përse ato janë ofruar.

Asnjëherë mos ruani të dhënat personale më gjatë sesa është e nevojshme.

1.6 Asetet e Bankës dhe të Grupit

Informacioni konfidencial

Çdo informacion, e dhënë, dokument, akt apo veprimtari i lidhur me mbarëvajtjen e përditshme, kërkimin dhe zhvillimin e projekteve, metodat e prodhimit, planet e biznesit, të dhënat financiare, të marketingut, strategjitë e shitjes, hedhjen në treg të produkteve të reja, bashkimet ose aktivitete të tjera, konsiderohen konfidenciale.

Punëmarrësit e Tirana Bank dhe Grupit Balfin duhet të trajtojnë me kujdes informacionin konfidencial të marrë, krijuar, transmetuar, shumëfishuar apo zbuluar gjatë marrëdhënies së punës dhe duhet të sigurohen që ky informacion do t'ju jepet vetëm personave të autorizuar nga Tirana Bank dhe Grupi Balfin për t'u vënë në dijeni të informacionit, për qëllim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Për më tepër, të gjithë punëmarrësit duhet të sigurohen që çdo person të cilit i zbulohet ndonjë informacion konfidencial, të zbatojë kushtet e detyrimit për ruajtjen e informacionit të fshehtë dhe sekret.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit mbi çdo informacion vazhdon edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës me Tirana Bank ose Grupin Balfin..

Nëse ndonjë prej punëmarrësve shkel parimin e konfidencialitetit, sa më sipër, kjo do të sjellë aplikimin e masave ndëshkuese përkatësisht.

Nga të gjithë ne pritët që:

Të ndajmë informacionin konfidencial vetëm me personat që është e nevojshme të zbulohet dhe vetëm në përmbushje të marrëdhënies kontraktore.

Të jemi të kujdesshëm ndaj aktiviteteve të dyshimta të konkurrencës apo ndaj palëve të treta, që mund të dëmtojnë asetet dhe interesat e Tirana Bank ose Grupit Balfin.

Të respektojmë detyrimin kontraktual të konfidencialitetit edhe pas përfundimit të kontratës së punës

Ju lutem referohuni Politikave dhe Procedurave për këtë temë të publikuara në intranet të Tirana Bank për t'u respektuar nga të gjithë punonjësit e Tirana Bank.

Asetet e Bankës dhe të Grupit

Mjetet e komunikimit elektronik

Termi "Infrastruktura Elektronike Balfin" mbulon telefonat e Bankës dhe të Grupit, kompjuterat, mjetet e lëvizshme të komunikimit elektronik si laptop ose telefona celular të cilat përmbajnë sistemet e pajisjes me e-mail, intranet dhe sistemet e internetit. Mjetet elektronike të komunikimit duhet të përdoren kryesisht për qëllime të biznesit.

Punëmarrësit Balfin mund të përdorin për qëllime personale Mjetet Elektronike të Komunikimit, vetëm duke respektuar parakushtet e përcaktuara në direktivat e brendshme. Përdorim personal do të thotë çdo rast i përdorimit të infrastrukturës elektronike i cili nuk është i lidhur direkt me qëllime të biznesit të Grupit. Punëmarrësit të cilët kanë akses në Mjetet Elektronike të Komunikimit duhet ti trajtojnë ato me kujdesin e duhur duke u siguruar që nuk janë të dëmtuar, humbur ose zëvendësuar. Përveç kësaj, punëmarrësit e Tirana Bank apo Grupit Balfin duhet të respektojnë standardet e sigurisë IT, p.sh. ata nuk janë të lejuar të instalojnë ose përdorin hardëare ose softëare në çdo sistem që nuk është miratuar në mënyrë specifike nga specialistët e IT.

Q: Një mik më ka dërguar një softëare interesant të cilin do të doja ta shkarkoja në kompjuterin tim në punë. Më lejohet ta bëj këtë?

A: Jo, juve nuk ju lejohet të instaloni ose përdorni hardëare ose softëare në asnjë nga sistemet e Tirana Bank që nuk është miratuar paraprakisht nga specialistët e IT.

Q: Kur shkoj me pushime I jap fjalëkalimin tim personal një kolegu në mënyrë që të aksesoj e-mailin tim për ta kontrolluar, ndërsa unë jam larg. A më lejohet të zbulojë fjalëkalimin tim personal?

A: Jo. Asnjëherë mos I jepni akses një personi tjetër në kompjuterin tuaj me fjalëkalimin personal. Me fjalëkalimin tuaj, kolegu mund të hyjë dhe të përdori të dhënat për të cilat nuk është i autorizuar dhe të bëjë ndryshime të paautorizuara, fshirje apo shtesa të të dhënave.

Nga të gjithë ne pritët që:

Të përdorim mjetet elektronike të komunikimit në Tirana Bank dhe Balfin vetëm për qëllime të biznesit dhe ti trajtojmë me kujdesin e duhur. Sigurohemi që të gjitha parakushtet për përdorim personal të kësaj infrastrukture të jenë plotësuar, në rast se doni të përdorni mjetet elektronike të komunikimit për qëllime personale.

Respektojmë Direktivat dhe Rregulloret e IT të publikuara në intranet dhe në sharelist.

Ju lutem referohuni Politikave dhe Procedurave për këtë temë të publikuara në intranet të Tirana Bank për t'u respektuar nga të gjithë punonjësit e Tirana Bank.

1.7 Kërkoni ndihmë dhe Raportoni

Në punën tonë të përditshme, ne mund të përballemi me situata të cilat nuk janë mbuluar në mënyrë specifike nga "Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale" të Tirana Bank dhe Grupit Balfin. Nëse ne jemi të pasigurtë në lidhje me sjelljet etike, ne duhet t'i bëjmë vetes pyetjet e mëposhtme:

- A është sjellja ime ligjore?
- A është në përputhje me vlerat dhe parimet e Tirana Bank dhe Grupit?
- A respektoj Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Tirana Bank dhe Grupit Balfin?
- A mund të ketë pasoja negative për Grupin ose veten time?

Q: Kur duhet të raportoj unë?

A: Nëse ju mendoni se "Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale" po çënohet atëherë ju duhet patjetër të raportoni. Menaxheri juaj është zakonisht pika e parë e kontaktit. Nëse nuk ndiheni komod të diskutoni një çështje të caktuar me të, drejtohuni te menaxheri i supervisorit tuaj, Departamenti i

Burimeve Njerëzore ose shkruani në adresën e Tirana Bank whistle-blowing@tiranabank.al ose Grupi Balfin te raporto@balfin.al.

Nga të gjithë ne pritët që:

Të raportojmë kur ne besojmë në mirëbesim se dikush ka bërë, është duke bërë, ose mund të jetë gati për të bërë diçka që shkel "Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale" të Tirana Bank dhe Grupit Balfin

Të diskutojmë shqetësimet me supervizorin apo t'i transmetojmë nëpërmjet linjave të tjera të raportimit.

Të përdorim kanalet e tjera të raportimit që kemi në dispozicion nëse nuk ndihemi komodë në lidhje me ngritjen e një shqetësimi tek Supervizori ynë.

Kërkoni ndihmë dhe raportoni

Çdo shkelje e "Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale" do të analizohet rast pas rasti dhe mund të përfshijë sanksione të tilla si:

- Paralajmërim për përjashtim nga puna
- Ndërprerje të marrëdhënieve të punës

Nëse Tirana Bank dhe Grupi Balfin konstatojnë se ndonjë nga punëmarrësit është në shkelje të "Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale", do t'i drejtohet autoriteteve kompetente dhe do të marrë masat për rregullimin dhe ndëshkimin e kësaj shkelje..

Kontakte

Nëse keni nevojë për të adresuar çdo çështje ose shkelje të kodit të etikës, te Tirana Bank apo në nivel Grupi, ju mund të shkruani në adresën zyrtar: për Tirana Bank te whistle-blowing@tiranabank.al ose për Grupin Balfin te raporto@balfin.al